



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:148787

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05542032

Ac.nr.6709/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditësit H.M. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson av. A. H. nga P., kundër të paditurës Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës neni 35 par.7 KKAK-ës, me vlerë të kontestit 524.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2362/2022, të datës 28.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më **04.04.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA THEMELTË, ankesa e të paditurës Komuna e Mamushës, ushtruar përmes përfaqësuesit të saj ligjor, Cabej Nurkollar, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2362/22, e datës 28.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2362/22 të datës 28.07.2023, vendosi si në vijim:

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit H. M. nga P. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të shujtave ditore për **262 ditë** pune gjatë periudhës kohore nga data 01.12.2020 deri më 30.04.2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **524.00 (pesëqind e njëzetë e katër) euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të kërkesës me datë 18.05.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124,00 (njëqind e njëzet e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës parë në rigjykim.

Paditësi, brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të palës së paditur, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, Komuna e Mamushës, ushtruar përmes përfaqësuesit të saj ligjor Cabej Nurkollar, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi H.M. nga P., përmes të autorizuarit të tij, avokat A. H. nga Prishtina, me datë 21.07.2022 ka ushtruar padi me kërkesë për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë për periudhën kohore për vitin 2020-2022 si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kundër të paditurës Komuna e Mamushës, duke kërkuar kompensimin e shujtave dite prej 2 euro për një ditë punë për 262 ditë punë në lartësinë e aprovuar si në aktgjykimin e ankimuar, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se duke u bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shpëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022, kjo kontratë më nuk është në fuqi dhe se nuk prodhon efekt juridik. Ka theksuar se paditësi nuk ka ofruar prova që është anëtarë i sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Mamushës shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veprojë në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Në fund ka theksuar se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Sa i përket pjesës së padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e shujtës për vitin 2020, këto detyrime të pretenduara nga ana e palës paditëse kanë qenë në

Kontratën Kolektive të vitit 2017 por kjo kontratë më nuk prodhon efekt juridik pasi që në vitin 2021 është lidhur Kontrata e re Kolektive 01/13 nr.prot.105 me datës 22.01.2021. Në fund ka theksuar se duke u bazuar në Ligjin e Marrëdhëniet e detyrimeve neni 353 të drejtat që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e vitit 2017 janë parashkruar, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Sa i përket shpenzimeve ka theksuar se të gjitha palët i bartin shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura, pa mbajtur shqyrtimin kryesor në kuptim të nenit 398 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në SH.F.M.U. “Anadolu” në Mamushë, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes kontratës së punës për mësimdhënës të datës 01.09.2021 ka vërtetuar faktin se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në SH.F.M.U. “Anadolu”, në Mamushë në vendin e punës Mësimdhënëse për Vizatim dhe Muzikë.

Nga vërtetimi i datës 29.04.2022 të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi H.M. prej muajit dhjetor 2020 deri më 30.04.2022 ka qenë prezent në punë 262 ditë pune.

Nga vërtetimi i datës 26.04.2022 të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi H. M. është punëtorë në shkollën fillore “Anadolu” në Mamushë prej datës 01.09.2011 në cilësinë e arsimtarit Ed. Muzikore-M. zgjedhor.

Nga leximi i kërkesës të datës 18.05.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi H.M. i është drejtuar Komunës së Mamushës-Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e inflacionit në pagë, shujtave dhe shpenzimeve të rrugës.

Nga Leximi i përgjigjes së Drejtorisë Komunale të Arsimit në Mamushë nr.144-22 të datës 31.05.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se njëjta se e njëjta i ka paguar shpenzimet e shujtës – ushqimit nga data 18.04.2017 deri me datës 30.11.2020.

Nga leximi i listës së pagave në emër të paditësit, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjti merr pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe realizon pagën bazë në shumën prej 421.00 euro.

Kontratën e punës dhe vërtetimin e lartcekur, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimin e lëshuar nga ana e SH.F.M.U. “Anadolu”, në Mamushë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësit, gjykata ia falë besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për 262 ditë nga data 01.12.2020 deri me datën 30.04.2022, paditësja ka qenë në vendin punës.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim*”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si mësimdhënëse t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësin, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 262 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk

ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Po ashtu edhe sa i përket çështjes së thirrjes se pala paditëse ka rënë në parashkrim për ta kërkuar detyrimin përmes rrugëve gjyqësore, gjykata gjeti se një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore, pasi që kërkesa nuk është e parashkruar, pasi që është bërë brenda afatit 3 vjeçar, prej momentit kur është bërë e arritshme kërkesa.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të kërkesës pranë të paditurës me datë 18.05.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifën e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është njaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet

se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nënshkruar nga e paditura si autoritet i veçantë dhe se nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Gjykata e Apelit konsideron se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë “ 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata e Apelit, po ashtu e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë pa i kaluar procedurat administrative siç parashihet në nenin 82 të Ligjit të Punës 03/L-212 dhe gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “*Të gjitha kërkesat*

nga marrëdhënia e punës **në para**, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësja brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe kjo asesi nuk nënkupton se paditësja nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Po ashtu, për Gjykatën e Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës e cila në ankesë thekson se paditëses nuk i takon një kompensim i tillë për faktin se nuk është anëtare e SBASHK-ut dhe një pretendim të tillë e refuzon si jo të drejtë për faktin se dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nuk mund të aplikohet për sa i përket kushtit për anëtarësim ngase një kusht i tillë do të ishte diskriminues dhe do të cenonte të drejtën apo lirinë e abonimit në organizatat sindikale e po ashtu do të cenonte edhe parimin e barazisë të përcaktuar me nenin 24 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë t’ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është vërtetimi lidhur me ditët e pranisë në punë për paditësen, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit sikur të asaj të vitit 2017 ashtu edhe asaj të vitit 2021, të cilat në mënyrë identike përcaktojnë detyrimin e të paditurës që paditësve t’ua paguajë për një ditë të pranisë në punë shumën prej 2 euro, dhe duke marrë për bazë vërtetimet e paditëses të lëshuara nga e paditura për ditët e pranisë në punë, nga gjykata e shkallës së parë drejtë është vepruar për kompensimin e shumave si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 449 dhe 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6709/2023, datë 04.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka